



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Ministrja Harito në Beograd, diskutohet për shkëmbim nëpunësish civilë mes Shqipërisë dhe Serbisë
2017-03-07 11:37:00



Midis Shqipërisë dhe Serbisë do të ketë një marrëveshje për shkëmbim reciprok të nëpunësve civilë, çka do të ndihmojë të dy vendet të rrisin kapacitetet profesionale të Administratave Publike.

Lajmi është bërë i ditur nga vetë ministrja për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito, pas takimit që ajo ka zhvilluar në Beograd me homologen serbe Ana Brnabic.

“Takimet politike mes dy kryeministrave Rama e Vuçiç ishin shumë të rëndësishme. Ato krijuan të gjithë bazën për të punuar bashkë në fusha me interes reciprok. Tani duhet të ndërtojmë ura bashkëpunimi konkrete, në mënyrë që të mbështetet i gjithë vullneti politik në bashkëpunim konkret”, u shpreh ministrja Harito.

Në takimin me ministren Brnabic është vlerësuar se reformat në Administratën Publike dhe Shërbimet publike janë prioritete të padiskutueshme të të dy vendeve, në rrugën e tyre drejt integritimit në BE.

Ministrja Brnabic është interesuar të dijë më shumë lidhur me sistemin online të rekrutimit të nëpunësve publikë në Shqipëri, një sistem i vlerësuar si më i miri në rajon edhe në Progres Raportin e BE, por edhe për reformën në Shërbimet Publike, ku agjencia ADISA po ndryshon tërësisht mënyrën se si qytetarët marrin shërbimet në sporetelet e shtetit.

Nga ana tjetër Ministrja Harito ka vlerësuar ecurinë e mirë të Serbisë në fushën e mbështetjes së iniciativave të të rinjve të talentuar përmes mbështetjes së startup-eve të ndryshme. Harito u shpreh së Shqipëria ka shumë për të mësuar në këtë drejtim.

Të dy ministret kanë rënë dakord të nënshkruajnë një marrëveshje për një program të gjerë shkëmbimi punonjësish publik midis Shqipërisë dhe Serbisë. “Ekipet do të shkëmbejnë në mënyrë intensive informacion për mënyrë se si ne e kemi implementuar reformën në Administratën Publike. Më pas do të nënshkruajmë një marrëveshje, në vijim të dakordësisë edhe të dy kryeministrave për një program të gjerë shkëmbimi punonjësish publik midis Shqipërisë dhe Serbisë”, u shpreh ministrja Harito.